REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES / MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

PLANI I PUNËS SË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS 2024

Fjala e Kryetarit

Shtimja është dëshira jonë e kahmotshme për të qenë plotësisht e jetueshme sipas nevojave të të gjithë qytetarëve tanë dhe në harmoni me preferencat e të gjitha grupmoshave. Ky synim mua më ka shtyrë që të kandidoj në mënyrë që banorëve t'ua bëjmë një qytet siç e meritojnë dhe një komunë që është në shërbim të tyre. Këtë vizion do ta përmbushim me patjetër dhe nuk ka asnjë sfidë, pengesë a obstruksion që na ndalë nga ky drejtim. Sepse ne të gjithë kemi sakrifikuar nga vetja për të arritur deri këtu dhe deri tani ka qenë shumë më vështirë, mbase në sytë e dikujt e pamundur për ta paramenduar këtë hap në të cilin jemi. Në një vit të vetëm qeverisje, kemi dëshmuar se Shtimja mund të udhëhiqet pa u abuzuar me të mirën e saj publike. Kemi dhënë shembull se dyert tona janë gjithmonë të hapura, ashtu siç jemi edhe vet për ta pritur e për të diskutuar secilin që na sheh si adresë zgjidhjeje për problemet e tyre. Kemi treguar se është e mundur që qytetari të jetë jo vetëm prioriteti, por i vetmi shqetësim yni, që i japim tërë kohën e mundshme dhe duke lënë gjithçka tjetër anash. Sepse jemi plotësisht të vetëdijshëm që për shkak të një vazhdimësie të gjatë e të mbrapshtë, shumë të këqija janë stërkequr e shumë të mira janë humbur dhe plot të tjera nuk janë realizuar me qëllime të ndryshome personale, grupore apo klanore. Mirëpo, atij kapitulli i kemi dhënë përfundimisht fund të hekurt dhe jemi tejet të gëzuar që më nuk do të ketë kthim prapa dhe s'mund të ulet standardi i vendosur nga ne si udhëheqje e re dhe tërësisht e ndryshme nga e kaluara. Nevojat e Shtimes janë të mëdha e kapacitetet në funksion të përmbushjes së nevojave fatkeqësisht janë të vogla. Mirëpo, ne e zotërojmë vullnetin e palëkundur e këmbëngulësinë stoike për ta realizuar çdo zotim, me shpresën për të lëvizur edhe më tej. Për këtë jemi të bindur që mund ta bëjmë sepse të gjithë ne që e kemi marrë besimin qytetar e publik, punojmë si një ekip. Të gjithë e bëjmë më të mirën nga vetja dhe asnjëri nuk heziton të vë në dispozicion e të mos kursejë asgjë vetëm e vetëm për t'i dalë në krye platformës së përbashkët që e bën Shtimen komunë të qytetarëve dhe që i bën shtimjanët qytetarë me komunë në shërbim të tyre. Prandaj, ne do ta gjelbërojmë qytetin e do t'i ndiçojmë fshatrat, do t'i bëjmë shkollat ambiente të specializuara për mësim me mjedis të pastër e me mjete pune shkencore e laboratorike, duke mos e lënë anash sportin me palestra funksionale e me Stadium modern, gjithsesi me një përkujdesje për memorien tonë lokale kolektive duke e ndërtuar një Arkivë të qytetit bashkë me Bibliotekën e re, duke e zhvendosur Entin Special e duke ndërtuar

Qendrën e re Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe rikthimin në funksion të plotë të 4 QMF-ve. Ne do të përkujdesemi për një ambient të pastër që s'u lë asnjë vend asnjë deponie ilegale që do të ndikojë në pastrimin e ajrit për të gjithë qytetarët tanë. Plani ynë, mbase i parë në dritën e 21-vjeçarit të kaluar, mund të duket aq ambicioz sa i parealizueshëm. Mirëpo, unë zotohem se ditë pas ditë të gjithë ne do të jemi dëshmitarë të hapave konkretë të realizimit të secilës shkronjë të programit tonë. Dhe e gjithë kjo me një transparencë absolute dhe pa asnjë keqpërdorim. Sepse të tillë na duan qytetarët dhe kështu e kemi dashur ne Shtimen. Prandaj, të gjithë ne që jemi shumicë, do të marshojmë krah për krah për ta transformuar Shtimen dhe për t'i dhënë kuptim dashurisë tonë për të, vizionit tonë të përbashkët dhe jetës që e zhvillojmë këtu. Për Shtimen që do ta ndryshojmë!

Kryetari i Komunës - Qemajl Aliu

PRIORITETET E PROGRAMIT

- **Përmirësimi i infrastrukturës ekonomike dhe sociale;**
- **Terheqja e investimeve në bashkëpunim me diasporën;**
- **Përkrahja e fermerëve me subvencione, krijimi i kushteve për rritjen e prodhimit dhe cilësisë të produkteve bujqësore;**
- **Zgjerimi i gamës së inkasimit të të hyrave buxhetore të Komunës dhe menaxhimi në mënyrë transparente;**
- **Kyçja e banorëve të lagjeve dhe fshatrave në sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit;**
- **Mbështetja e bizneseve në hapjen e vendeve të reja të punës.**
- **Rregullimi i rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit në fshatra dhe në qytet;**
- **Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave dhe ngritjes së cilësisë në arsim**
- **Mbrojtja, menaxhimi i burimeve natyrore dhe mjedisit;**

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2024

Hyrje

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Shtimës nr. 01-06/1636 të datës 03.09.2008, Kryetari i Komunës ka formuar grupin punues për hartimin e Planit të Punës 2024.
Me qëllim të përmbushjes së objektivave, ky plan i Punës së kryetarit përmban aktivitete, detyra dhe ka të përcaktuar afatin kohor për realizimin e tyre, për vitin 2024.

Fokusi i punës do të jetë mbi bazën e arritjes së qëllimeve të përcaktuara për këtë vik kalendarik duke pasur një Administratë që ofron shërbime cilësore, duke rritur nivelin e shërbimeve digjitale - online bazuar në kërkesat e qytetarëve, njëkohësisht duke ngritur kapacitetet profesionale për një zhvillim të qëndrueshëm Ekonomik, planifikim urban dhe rural, mbrojtje të mjedisit, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimev e komunale. Ofrimin e arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor e të mesëm ulet dhe të lartë). Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin e shëndetit primar shëndetësor, kujdesin për strehim, të moshuarit, fëmijët,, punësimin, banimin pulik, aktivitetet kulturore, sportive, rininë. Transportin lokal publik dhe taksitë, emërimin e rrugëve,, rrugicave si dhe vendeve të tjera publike, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike, turizmit.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij plani për vitin 2024 është që Zyra e Kryetarit të Komunës të ushtrojë me sukses përgjegjësitë dhe detyrat e punës dhe t'i realizojë në tërësi objektivat e parapara; të ketë nën mbikëqyrje dhe të kontrollon të gjitha programet, projektet, shërbimet dhe aktivitetet e Komunës; duke zbatuar ligjet dhe udhëzimet admnistrative në lidhje me qeverisjen komunale dhe në ushtrimin e kompetencave të duhura të Kryetarit në zbatimin e politikave dhe programeve të miratuara dhe kështu të vazhdojë përmbushjen e misionit të Kabinetit të tij.

Objektivat

- Planifikimi urban, hartat zonale, lëshimi i lejeve për ndërtim dhe i lejeve për biznese;
- Ofrimi i shërbimeve administrative të shpejta dhe cilësore duke rritur nivelin e digjitalizimit për qytetarët e komunës së Shtimes;
- Ofrimi i shërbimeve publike komunale të ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza, infrastrukturës rrugore lokale, trotuareve, ndriçimit, stazave të biçikletave, transportit;
- Ndërtimi i infrastrukturës për krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik lokal, zonat e biznesit, zonat për bujqësi, blegtori, turizëm dhe zhvillim rural;
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për fëmijët parashkollor, fillor, të mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë;
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe furnizimeve të kujdesit primar shëndetësor;
- Implementimi i planit lokal të veprimit në mjedis, mbrojtja lokale e ambientit;
- Identifikimi, evidentimi dhe menaxhimi i pronës komunale;
- Vazhdimi i implementimit të projekteve infrastrukturore;
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe të banimit për kategoritë në nevojë;
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe të banimit;
- Mbështjetja e aktiviteteve kulturore, sportive dhe të rinisë;

- Mbështetja dhe avancimi i vlerave njerëzore dhe qytetare;
- Vendosja e marrëdhënieve për bashkëpunim me të gjitha organizatat qeveritare, joqeveritare dhe ato ndërkombëtare si: USAID, GIZ, UNDP, HELVETAS, etj. për arritjen e rezultateve në punë;
- Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit publik;
- Organizimi i panaireve dhe funsionalizimi i tregjeve;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të zjarrfikësve, shërbimet për mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
- Forcimi i sektorit të biznesit duke ofruar klimë të favorshme investimi.
- Promovimi dhe sigurimi i zhvillimit të marëdhënieve ndërnjerëzore barazisë gjinore, parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje;
- Promovimi dhe forcimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet;
- Ruajtja e sigurisë publike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe pronave.
- Forcimi i bashkëpunimit dhe ndërlidhjes ndërmjet niveleve më të larta të qeverisë, institucioneve të huaja, OJQ-ve, Ndërrmarrjeve Publike dhe sektorit privat;
- Angazhim dhe punë drejt ngritjes së cilësisë së punës dhe bashkëpunimit të brendshëm, si dhe ngritjes së kapacitetit të stafit në kryerjen e detyrave të tyre,
- Mbështetja e stafit të komunës në aplikimin e praktikave të mira të shërbimit dhe komunikimit me qytetar;
- Forcimi dhe Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë natyrore dhe Menaxhimi i situatave nga vërshimet, zjarri etj.
- Rritja e produktivitetit bujqësor nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së kullimit të tokave bujqësore, rregullimit të rrugëve të arave, nëpërmjet dhënjes së insentivave për fremer, aplikimit të praktikave të mira, organizimit të trajnimeve, seminareve, ofrimit të shërbimeve këshillimore si dhe zhvillimit të teknologjisë së duhur për prodhimtari të integruar dhe duke aplikuar praktikat e mira bujqësore.

- Ofron mbështetje infrastrukturore (energji, rrugë ferma në treg, ura, zhvillimi i kullimit, sistemi i ujit të pijshëm, betonimi i rrugëve/rrugëve, etj.) për akses të lehtë në prodhim dhe treg.
- Forcimi i qeverisjes lokale përmes menaxhimit të financave publike dhe zhvillimi i një udhërrëfyesi drejt të gjitha niveleve të zhvillimit.
- Të krijohet një strukturë e fortë organizative të drejtorive përkatëse, që mundëson ofrimin e shërbimeve bazë duke iu përgjigjur nevojave të qytetarëve;
- Forcimi i sistemit për racionalizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore, rritjes së kapaciteve të prodhimit të ujit të pijes, shpërndarjes së rrjetit të ujësjelësit dhe kanalizimeve, përpunimi i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike në të gjitha fshatrat dhe në vet qytetin e Shtimës.
- Nxitja e zhvillimit të sektorit minerar dhe racionalizimi i zhvillimit të tij pa dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
- Forcimi i marrëdhënieve me OJQ-të, Ndërrmarrjet publike dhe Organizatave të tjera të Shoqërisë Civile, Grupin Lokal të Veprimit për Planifikimin e Veprimit Lokal për Reduktimin e Varfërisë dhe zbatimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve buxhetore në përputhje me rregullat, rregulloret dhe qarkoret në fuqi.

DREJTORITË DHE ZYRET NË KUADËR TË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- **Drejtoria për Arsim – Yllka Fejzullahu**
- **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – Albana Fazliu**
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Muharrem Asllani**
- **Drejtoria për Shërbime Publike- Bardhyl Rushiti**
- **Drejtoria për Prokurim Publik**
- **Drejtoria për Administratë të Përgjithshme – Valon Januzi**
- **Drejtoria për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve – Gonxhe Osmani**
- **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – Kastriot Shabani**
- **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Gojart Bajrami**
- **Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis, Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti**
- **Zyra për Komunikim me Publikun – Vlora Hyseni**
- **Zyra Ligjore – Lulzim Muharremi**
- **Zyra për Komunitete dhe Kthim**

Drejtoria për Arsim

Plani i Punës Njëvjeçare i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Shtime do të ngërthej në vete aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASHTI-n, drejtoritë tjera komunale, me qytetarët, komunitetin e prindërve si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediet, komunitetin, etj. Plani i punës ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendeve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin e përhershëm të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

Pra, në këtë plan janë përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara për katër nivelet shkollore sipas Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (SNKA):

- SNKA 0 - Klasat Parafillore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje - 5 vjeç),
- SNKA 1 - Arsimi Fillor (Klasat I-V),
- SNKA 2 - Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII).

Ky plan ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes siç janë:

1. IP “Albiona Asallani” – Shtime
2. SHFMU “Abdullah Shabani” – Carralevë
3. SHFMU “Bajram Curri” – Petrovë
4. SHF “Emin Duraku” – Shtime
5. SHMU “Emin Duraku” – Shtime
6. SHFMU “Hasan Prishtina” – Godanc
7. SHFMU “Idriz Ajeti” – Pjetërshticë
8. SHFMU “Lasgush Poradeci” – Muzeqinë
9. SHFMU “Skënderbeu” – Reçak
10. Gjimnazi “Naim Frashëri” – Shtime
11. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional – Shtime

Plani i punës së aktiviteteve në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2023/2024

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor								✓					DA
Funksionalizimi i çerdhes së vjetër në Bashkësinë e Pestë në Shtime					✓	✓							DA
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2023-2024 në fund të gjysmëvejtorëve si dhe në fundin e vitit shkollor (informatë për Kuvend)	✓						✓						DA

Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e Komunës në shkolla me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve									✓				**DA-Zyra e Kryetarit**
7 Marsi – Dita e Mësuesit			✓										Shkolla-DA
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe klasën përgatitore (parafillor)					✓								Shkolla-DA
22 Prill – Dita e Tokës (Java e gjelbërimit për shkollat e komunës)				✓									DA, Komuna & Shkolla

Shënimi i Festës së Abetares					✓								**Shkolla-DA**
Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme		✓	✓	✓									Shkolla-DA
Organizimi i Garës Komunale të Diturisë-2024					✓								Shkolla-DA
Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024						✓							DA
Bashkëpunimi me MASHTI-n, dhe Inspektoratin e Arsimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave							✓	✓	✓				DA

Organizimi i garave shkollore në sport si në: futboll të vogël, basketboll, volejboll, atletikë,shah, pingpong etj			✓	✓	✓	✓							**DA**
Kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHTI me qëllim publikimi të konkursit për regjistrim të nxënësve në Gjimnaz dhe IAAP (Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional)				✓	✓								DA-MASHTI
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta						✓	✓	✓	✓				DA
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta								✓					DA-MASHTI

Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	**DA**
Formimi i komisionit për përgatitjen e testit vlerësues dhe respektimit të procedurave për përzgjedhjen e personelit arsimor					✓	✓	✓	✓					DA
Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkurues	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Përgatitja e vendimeve për shkuarje në pushim vjetor të punëtorëve arsimor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA

Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues								✓					**DA**
Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditar pune, libra të amzave, libra të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor							✓	✓					Shkolla-DA
Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve njëditore të semimaturantëve dhe maturantëve					✓	✓							Shkolla-DA
Raporti 6 mujor i Drejtorisë për Arsim						✓						✓	DA
Plani i punës për vitin 2024 i Drejtorisë për Arsim.	✓												DA

Përgatitja teknike e lokaleve shkollore: gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri.							✓	✓					**Shkolla-DA**
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse: dru dhe pelet.					✓	✓	✓						DA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse: dru dhe pelet.							✓	✓					DA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla							✓	✓	✓				DA-Shkolla
Riparimi i nyjeve të ujësjellësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA

Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike në salla të kabineteve për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji, Si dhe banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore			✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓			
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive				✓	✓	✓	✓	✓	✓			
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore						✓	✓	✓	✓			
Themelimi i Këshillit të Prindërve të Komunës									✓			

Qarkorja e parë (15 maj – 30 qershor) me kufi buxhetor për hartimin e KAB-it					✓	✓							**ZKF-DA-Shkolla**
Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)					✓	✓							ZKF-DA-Shkolla
Qarkorja e dytë buxhetore dhe planifikimi i buxhetit për vitin fiskal 2025 nëpër kategori ekonomike (1 gusht – 30 shtator)								✓	✓				ZKF-DA-Shkolla
Futja e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Zhvillimit të Buxhetit (BDMS)								✓					ZKF-DA
Përgatitja e Planit të Prokurimit për institucionet arsimore											✓		DA-Shkolla

Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	**E përhershme, sipas nevojës**	**Shkolla-DA**
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave	Shkolla-DA
Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorë	Sipas kërkesave	Shkolla-DA
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave	Shkolla-DA

Plani i punës së procesit edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2023/2024

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Rregullimi i dokumentacionit për pronat e shkollave sipas sipërfaqeve kadastrale	E vazhdueshme												DA
Monitorimi i Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA)	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Organizimi i mësimit shtesë për maturantët	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-Shkolla
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-Shkolla
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të komunës së Shtimes	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA, MASHTI, KEC, AUK, USAID, GIZ

Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë e përhershme	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	**DA**
Bashkëpunimi me OJQ-të në fushën e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkolla-detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës etj.	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Analiza e punës edukativo-arsimore	✓				✓		✓			✓			DA
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave	Sipas nevojave												DA
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojave												DA

Vlerësimi i punës edukativo-arsimore të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				✓	✓	✓			✓	✓	✓	✓	**DA-Shkolla**
Përgatitja profesionale e mësimdhënësve, organizimi i trajnimeve në koordinim me MASHTI-n dhe organizatat tjera					✓	✓				✓	✓	✓	DA-Shkolla
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-së jashtë vendit						✓	✓						DA
Përcjellja e përhershme e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme												DA-Shkolla
Shpallja e konkurseve për personelin udhëheqës – drejtor të shkollave	Sipas nevojës												DA

Përcjellja e realizimit të Mbrëmjes së Maturës					✓	✓							**DA-Shkolla**
Përgatitja për Testin Ndërkombëtar TALIS					✓	✓							MASHTI-DA
Përgatitjet për organizimin e Vlerësimit Ndërkombëtar PISA-2025			✓		✓								MASHTI-DA
Mbarimi i mësimit për maturantët	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI-DA
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												Shkollat
Provimi i Maturës Shtetërore	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI-DA
Publikimi i rezultateve të provimit të matures	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI-DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI-DA

Publikimi i rezultateve të ankesave **Testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta**	**Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI**	**MASHTI-DA**
	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Paraqitja e provimit për afatin e gushtit	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	DA
Provimi i maturës-afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI-DA

Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DA-së me Kryetarin e Komunës, MASHTI-in, Drejtoritë Komunale dhe Qytetarët

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Takimet dhe konsultimet me Kryetarin e Komunës	Të përhershme, sipas nevojës												DA
Takimet e rregullta me MASHTI-in në kuadër të takimeve me drejtorët e DA-së	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DA-MASHTI
Furnizimi me ligjet, udhëzimet administrative, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHTI	Sipas nevojës												DA-MASHTI
Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informative nga aktiviteti i DA-së në MASHTI	Sipas nevojës												DA-MASHTI
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DA-ve të Kosovës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA-MASHTI

Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)		✓		✓		✓		✓		✓		✓	**DA**
Pjesëmarrja në mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore të mesme të ulët, të mesme të larta dhe institucionit parashkollor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DA

Përgatitja dhe hartimi i Draft-Planit Strategjik për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2024-2028	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	**DA-Shkollat**
Takime me Shërbimin Pedakogjik-Psikologjik	Sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspektorëve të Arsimit në nivel regjional	Sipas nevojës												DA
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi me Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Sipas mundësive dhe nevojës												DA

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Arsimit me organet e sigurisë: Policinë, FSK-në, KFOR-in, OJQ-të dhe mediet

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore, organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DA
Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi me Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)	Sipas nevojës												DA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me donatorë vendor e të huaj	Sipas nevojës												DA

Realizimi i projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve në arsim

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DA
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimdhënsve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	Në vazhdimësi												DA

Projektet e planifikuara për vitin 2024

Nr.	Arsim dhe shkencë	Shuma në €
1	Ndërtimi i shkallëve për Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime (Rr. “Isa Boletini”) (Faza dytë	38.000 €
2	Renovimi i institucioneve arsimore: SHFMU “Lasgush Pordeci” në Vojnoc, SHFMU “Bajram Curri” në Petrovë, SHFMU “Emin Duraku” në Shtime, Lagje Pajtimit, Belinc dhe Gjimnazi “Naim Frashëri”	50.000 €
3	Ndërtimi i sallave në Reçak dhe Zborc (faza e dytë)	95.000 €
4	Rregullimi i oborreve dhe rrethojave të shkollave: Carralevë, Gjyrkoc, IAAP, Davidoc dhe Çerdhe.	20.000 €
5	Funksionalizimi i sallave të Edukatës Fizike: Muzeqinë, Carralevë dhe Petrovë	14.150 €
6	Gjeneratori i ShFMU “Abdullah Shabani” Carralevë	10.000 €
7	Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumit të parë në Kosovë në Rashincë (Faza Dytë	50.000 €
8	Renovimi i Çerdhës së Vjetër në Shtime	100.000 €
9	Funksionalizimi i Çerdhës në fshatin Muzeqinë	MASHTI
10	Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në Godanc– SHFMU “Hasan Prishtina”	MASHTI
11	Ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Petrovë	MASHTI
12	Ndërtimi i Çerdhes së Fëmijëve në Godanc	MASHTI
13	Ndëritimi i aneksit në Petrovë dhe renovimi i shkollës aktuale	MASHTI
14	Renovimi i ShFMU “ Lasgush Poradeci” paralelja e ndarë në Vojnoc	MASHTI

Buxheti i Arsimit për vitin 2024 sipas kategorive

Kodi i programit	Përshkrimi	Stafi	Paga dhe mëditje	Mallëra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Gjithsej
920	Arsim dhe Shkencë	480	3,438,818.00	314,841.00	70,917.00	53,500.00	228,000.00	4,106,076.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim							
	Granti Specifik për Arsim		3,438,818.00	258,145.00	70,917.00	33,500.00	198,000.00	3,999,380.00
	Të Hyrat Vetanake		0.00	56,696.00	0.00	20,000.00	30,000.00	106,696.00
	Subvencionet		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
935	Administrata e Arsimit	4	34,911.00	5,000.00	0.00	53,500.00	0.00	93,411.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim							
	Granti Specifik për Arsim		34,911.00	5,000.00		33,500.00		73,411.00
	Të Hyrat Vetanake					20,000.00		20,000.00
92330	Arsimi Parashkollor	41	270,325.00	80,059.00	15,217.00		20,000.00	385,601.00
	Granti i Përgjithshëm për Arsim							
	Granti Specifik për Arsim		270,325.00	24,863.00	15,217.00		20,000.00	330,405.00

93180	**Arsimi Fillor**	**335**	**2,380,633.00**	**191,072.00**	**42,700.00**	**0.00**	**199,150.00**	**2,813,555.00**
	Granti i Përgjithshëm për Arsim							
	Granti Specifik për Arsim		2,380,633.00	190,072.00	42,700.00	0.00	169,150.00	2,782,555.00
	Të Hyrat Vetanake			1,000.00	0.00	0.00	30,000.00	31,000.00
	Arsimi i Mesëm	100	752,948.00	38,710.00	13,000.00		38,850.00	843,508.00
94380	Granti i Përgjithshëm për Arsim							
	Granti Specifik për Arsim		752,948.00	38,210.00	13,000.00	0.00	38,850.00	843,008.00
	Të Hyrat Vetanake			500.00	0.00	0.00		500.00

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Nr.	Muaji	Aktivitetet	Sektorët
1.	Janar	• Mbledhja e pare me stafin për vitin 2024 si dhe vlerësimi i performancës për stafin dhe sektoret e drejtorise per vitin 2023. • Analiza e sfidave, plani i punes se bashku me stafin si dhe caktimi i objektivave per secilin zyrtar dhe secilin sektor • Plani i shpenzimeve për vitin 2024, projekte kapitale, paga, mallra dhe shërbime. • Hartimi i planti të prokurimit për vitin 2024 • Përgjigje me shkrim në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve • Themelimi i ansamblit te kengeve dhe valleve “ILIRIDA” Shtime • Organizimi i punës në Shtëpinë e Kulturës • Organizimi i aktiviteteve kulturore kushtuar 15 Janari – Ditet e Reçakut • Organizimi i akademis përkujtimore për 15 Janarin – Masakra e Reçakut • Organizimi i akdemise perkujtimore per 19 Janarin per heroin Ahmet Kaqiku • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Biblioteke • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • • Hartimi i planit të punës dhe rregullave në Palestren Sporitve • Organizimi i mbrendshëm i stafit dhe punës në Palestren Sportive • Hartimi i orarit pë klubet sportive në Palestren Sportive • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive • Thirrja per përzgjedhjen e sportistit te vitit • Krijimi i hapsirave për të rinjët e Qendres Rinore • Përgatitja e konkursit për licencimin e Qendres Rinore • Takime me të rinjët e organizatave rinore	Sektori i Kulturës Sektori i Sportit Sektori i Rinisë

2.	**Shkurt**	• **Pergaditja e dokumentacionit për thirrjen publike për subvencione** • **Përgatitja e projekteve dhe hartimi detal i tyre për vitin 2024 per investimet kapitale.** • **Bashkpunim me institucione tjera komunale, shteterore dhe OJQ -ve** • **Organizimi dhe shenimi i 17 Shkurtit – Dita e Pavarësisë** • **Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek** • **Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore** • **Krijimi i bashkëpunimit me teatrot tjera ne nivel vendi** • **Organizimi i turneut në Futboll te vogel me rastin e 17 Shkurtit** • **Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit janar** • **Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive** • **Bashkëpunimi me Federatat e Sportit** • **Perzgjedhja e sportistit te vitit** • **Bashkpunim me organizatat rinore për aplikim tek donatorët e jashtëm** • **Njoftimi i te rinjeve per thirrjen publike per ndarjen e subvencioneve per rini**	**Sektori i Kulturës** **Sektori i Sportit** **Sektori i Rinisë**

3.	**Mars**	• **Përgaditja e dokumentacionit për shpalljen e projekteve kapitale.** • **Kontrollimi i lëndëve dhe dërgimi i tyrë në komisonin për ndarjen e subvencioneve** • **Përgjigje me shkrim në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.** • **Kryerja e punëve dhe aktiviteteve të përditshme** • **Raporti i OJQ-ve për punen dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2024** • **Përgatitja e raportit 3 mujor** • **Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (6 Marsi – Dita e Dëshmorëve, 7 Marsi – Dita e Mësuesit, 8 Marsi – Dita e Gruas)** • **Ora letrare – 21 Marsi dita ndërkombetare e poezisë** • **Formimi i grupit punues për hartimin e planit për trashegimisë kulturore** • **Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek** • **Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore** • **Organizimi i orarit të ndeshjeve zyrtare të të gjitha klubeve sportive** • **Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit shkurt** • **Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive** • **Organizime te ndryshme te aktivitetev Rinore** • **Shfaqje teatrale per femije**	**Sektori i Kulturës** **Sektori i Sportit** **Sektori i Rinisë**

4.	Prill	• Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve komunale • Vlerësim tre-mujor i stafit të drejtorisë mbi punët dhe aktivitete. • Plani i pushimeve verore për sektoret. • Pjesëmarrje aktive në trajnimin e stafit profesional, • Ore letrare • Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (22 Prill – Dita e Tokës dhe 23 Prill – Dita botërore e Librit dhe të drejtës së Autorit) • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • Shfaqje teatrale “Dit Vere” dhe • Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit mars • Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive • Masovizimi i rinisë në aktivitetet rinore dhe inkuadrimi i tyre ne OJQ lokale	 Sektori i Kulturës Sektori i Sportit Sektori i Rinisë

5.	Maj	• Përcjellja e realizimit të projekteve • Raportimi për ecurinë e projekteve ne terren	
		• Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (5 Maji – Dita e Kazermes në Pjetërshticë dhe 9 Maji – Dita e Evropës) • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • Shfaqje teatrale “Antigonat e Kosoves”	Sektori i Kulturës
		• Licencimi i klubeve sportive • Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit prill • Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive	Sektori i Sportit
		• Përvjetori i themelimit te KVRL-së (7 Maj)	Sektori i Rinisë
		• Informate nga DKRS per Kuvendin Komunal	

6.	Qershor	• Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve komunale • Planifikimi i pushimeve verore me stafin, • Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, 5 Qershori – Dita Botërore e Ambientit dhe 12 Qershori – Dita e Qlirimit të Komunes së Shtimes.) • Organizimi i manifestimit “26 Qershorit” Shatabi UÇK së Rancë • ORGnizimi i garave shkollore ne bashkepunim me DKA-ne • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • Organizmi i Kampionatit të Kosoves ne Kick-box • Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit maj • Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive • Pergaditja e raportit 6 mujor te aktiviteteve ne palester • Organizimi i garave per nder te 12 Qershorit Dites se Qlirimit te Komunes se Shtimes. • Komunikimi me OJQ- lokale rinore dhe përgjigjja ndaj kërkesave të tyre	Sektori i Kulturës Sektori i Sportit Sektori i Rinisë

7.	Korrik	• Përgatitja e raportit 6 mujor • Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve komunale • Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (26 Korriku – Dita e Dëshmorëve të Komunes së Shtimes) • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • Takimi me te gjitha Klubet sportive- rezultatet e arritura • Përshkrimi i aktiviteteve të sezonit pranveror për klubet sportive • Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit qershor • Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive	Sektori i Kulturës Sektori i Sportit Sektori i Rinisë

8.	Gusht	• Menaxhimi i projekteve dhe implementimi i tyre • Caktimi i prioriteteve për vitet 2024-2025 • Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave • Organizmi i koncertit tradicional për bashkëatdhetar • Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek • Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore • Hartimi i orarit pë klubet sportive në Palestren Sporitve • Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit korrik • Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara • Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive • Organizmi dhe shenimi 12 Gushtit - Dita Ndërkombëtare e Rinisë • Takim i te rinjeve me bashkatdhetare e rinje per shkembim te pervojave	Sektori i Kulturës Sektori i Sportit Sektori i Rinisë

9.	Shtator	• Menaxhimi i projekteve dhe implementimi i tyre	
		• Organizmi dhe shenimi i datave me rendesi (17 Shtatori – Dita e Rinise së Komunes së Shtimes dhe 21 Shtatori – Dita nderkombëtare e Paqës)	Sektori i Kulturës
		• Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek	
		• Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit	
		• Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore	
		• Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit gusht	
		• Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara	
		• Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive	Sektori i Sportit
		• Organizmi dhe shenimi 17 Shtatorit – Dita e Rinisë së Komunes së Shtimes	
		• Aktivitetet me te rinjet e Komunes se Shtimes per Diten e Rinise	Sektori i Rinisë

10.	**Tetor**	• **Përmbyllja e projekteve kapitale** • **Përgjige në kërkesat e qytetarëve dhe institucioneve** • **Shfaqje për fëmijë në Shtëpin e Kultures** • **Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek** • **Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore** • **Organizimi i aktiviteteve vetedijesuese per kancerin e gjirit** • **Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit shtator** • **Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive** • **Java e Rinise**	**Sektori i Kulturës** **Sektori i Sportit** **Sektori i Rinisë**

11.	**Nëntor**	• **Organizmi dhe shënimi i 28 nëntorit – Dita e Flamurit** • **Mbajtja e evidencës mujore për lexuesit në Bibliotek** • **Mbajtja e evidencës mujore për vizitorët në Muzeun e Qytetit** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore** • **Organizimi i turneut ne hendboll, volejboll dhe futsall për nder të 28 nëntorit** • **Raporti mujor për aktivitetet në palestër të muajit tetor** • **Mbajtja e evidencës mujore për të hyrat e inkasuara** • **Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve dhe tereneve sportive**	**Sektori i Kulturës** **Sektori i Sportit**
12.	Dhjetor	• 30 Dhjetori Dita e veteraneve te UÇK-se • Aktivitetet per festat e fundvitit • Takimi me te gjitha klubet sportive, kerkesat nevojat dhe mundesit e permiresimit te kushteve dhe sukseseve, • Raporti i punës njëvjeçar nga nëpunësit civil • Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, • Analizë e punës lidhur me sfidat në realizimin e objektivave. • Përgatitja e raportit të punës për vitin 2024 • Përgatitja e planit të punës për vitin 2025 • Barazimi përfundimtar për te hyrat inkasuara me sektorin e financave	Sektori i Kulturës,Rnisë dhe Sporitit

Drejtoria për Shërbime Publike

Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse dhe do të kontribuoj në hartimin dhe implementimin e politikave Komunale në fushën e shërbimeve publike, nëpërmjet ndërmarrjeve publike dhe institucioneve tjera që menaxhojnë dhe kujdesen për ofrimin e këtyre shërbimeve.

OBJEKTIVAT E DREJTORISË

1. Furnizim me ujë të pijes;
2. Menaxhimin e sistemit të kanalizimit;
3. Menaxhimin e mbeturinave;
4. Menaxhimin e investimeve kapitale në infrastrukturën publike;
5. Pastrimin, larjen dhe largimin e borës dhe akullit nga rrugët dhe trotuaret;
6. Sigurimin e mirëmbajtjes së parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
7. Funksionimin e tregjeve;
8. Ofrimin e shërbimeve lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe transportin lokal;
9. Kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta;
10. Planifikimin e nevojave shpenzuese dhe investuese të Drejtorisë.

Projektet e planifikuara për vitin 2024 janë si në vijim;

1. Furnizim për aktivitete të ndryshme
2. Furnizim me veshmbathje
3. Furnizim me kompjuter
4. Furnizim me drunjë dekorativ dhe lule, për rregullimin e hapësirave publike dhe parqeve në institucionet e komunës së Shtimes
5. Deratizimi, Dezinsektimi, Dezinfektimi i hapësirave publike dhe objekteve institucionale në komunën e Shtimes
6. Mirëmbajtja e infrastrukturës në komunën e Shtimes
7. Mirëmbajtja verore (kositja e barit)
8. Mirëmbajtja e varrezave
9. Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit
10. Mirëmbajtja e ndriçimit publik
11. Mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike
12. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve
13. Mirëmbajtja e pastërtisë, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave
14. Rregullimi i ndriçimit publik
15. Rregullimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në komunën e Shtimes
16. Rregullimi i vend ndaljeve të autobusëve në fshatrat Rashincë, Vojnovc, Carralevë, Mollopolc, Godanc dhe Shtime (2 vjeçar)

Projektet të reja:

1. Rregullimi i Kamerave në teritorin e Komunën e Shtimes
2. Rregullimi I ndriçimit Publik.
3. Rregullimi I Parqeve në Komunën e Shtimes

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE VEPRIMTARINË E USHTRON BAZUAR NË KORNIZËN LIGJORE SI NË VIJIM:

- Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/ L-040
- Statutin e Komunë së Shtimes
- Ligji Për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/ L-031
- Ligji Për Qasje Në Dokumente Publike 06/L-081
- Ligji Për Arkivat Shtetërore Nr.04/L-088
- Ligji Nr. 04 L 110 Për Ndërtim (Aktet nënligjore)
- Ligji Nr. 04 L 175 Për Inspektoriatin e Mjedisit Ujërave Natyrës Planifikimit Hapsinor dhe Ndërtim
- Ligji për transportin rrugor Nr.04/L-179
- LIGJI Nr. 03/L-025 2009 - LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
- LIGJI Nr. 08/L-071 2022 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA LIGJI Nr.03/l–233 2010 - LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS
- LIGJI Nr. 08/L-025 2022 - LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA

NDOTJA • Nr.04/ L-147 - LIGJI PËR UJËRAT E KOSOVËS

- LIGJ NR. 08/L-181 2022 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS
- UDHËZIM ADMINISTRATIV- NR. 07/2017 PËR LEJE MJEDISORE
- UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr 23/2012 PËR MENAXHIMIN E GOMAVE JASHT PËRDORIMIT DHE MBETURINAT E GOMËS
- LIGJI NR.08/L-067 PËR INSPEKTIMET
- LIGJI NR.05/L-087 PËR KUNDËRVAJTJE
- LIGJI NR.05/L-031 PËR PROCEDUREN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

- Ligji për inspekciorin bujqësor nr: 03/L-029.
- Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimve nr: 03/L-042
- Ligji per mbrojtjen e bimëve nr: 04/L-120
- Ligji për token bujqësore nr: 02/L-26
- Ligji për blektorin nr: 04/L-191
- Ligji për pasurimin e millit nr: 04/L-114
- Ligji për bletari nr: 02/L-111
- Ligji për kujdesin ndaj kafsheve nr: 02/L-10
- Ligji për materialin fidanor nr: 2004/13
- Si dhe udhzime te ndryshme administrative.

- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave
- Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba
- Rregullorja Komunale për Shërbime Publike
- Rregullore për transportin rrugor në territorin e komunës së Shtimes
- Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
- Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë
- Plani i Biodivirsitetit

Udhëzime, rregullore, Vendime dhe Urdhëresa tjera të nxjerra nga organet relevante të nivelit qendror dhe komunës.

PUNËT DHE DETYRAT E PLANIFIKUARA ME PRIORITET PËR VITIN 2024

